

Akt Thmelimi

I shoqerise tregtare "A&D SOLUTION" sh.p.k

Korce me 18.11.2024

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.B dhe formalitetet qe duhe respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi une ortaku :

Individ me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Tirane , krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "A&D SOLUTION" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Neni 1

Sot me dt. 18.11.2024 formohet shoqeria tregtare private e quajtur "A&D SOLUTION" sh.p.k

Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortakët themelues.

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private "A&D SOLUTION" sh.p.k do te kete seline ne:

Rr.Shaban Bardhoshi ,Ndertese Nr.12 , Njesia Administrative Nr.6 , Tirane ,Albania.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .

Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Objekti i shoqerise eshte:

Ndertimi dhe administrimi i impianteve industriale per prodhimin dhe/ose perpunimin kepuceve dhe aksesoreve te tyre.

Prodhimi dhe/ose perpunimi i suprinave, kepuceve dhe aksesoreve te tyre, perfshire komercializimin e prodhimeve me shuince e pakice.



Prodhimi dhe/ose perpunimi i suprinave, kepuceve dhe aksesoreve te tyre me lende te pare te importuar dhe rieksporim te prodhimit e jashte Shqiperise (FASON).

Prodhimin dhe/ose perpunimin artizanal te suprinave, duke perdorur fuqine punetore shtepiake.

Mundet gjithashtu te kryeje gjithë operacionet tregtare, financiare, mobiliare e imobiliare, qe eventualisht konsiderohen te nevojshme ose oportune per te aritur ose permbushjen e objektit shoqeror.

Shoqeria ka ndermend te realizoje inisiativa te reja produktive ne territorin shqiptar, duke perfitur nga perjashtimet fiskale dhe kredite nxitesse te parashikuara.

Tregtimi me shumice ose me pakice ne territorin shqiptar dhe jashte i te gjitha prodhimeve shqiptare ose jo.

Tregtimi me shumice dhe me pakice, si dhe importimi dhe eksportimi i prodhimeve industriale, agroushqimore, veshmbathjeve, kepuceve, drurit, prodhimeve artizanale etj. Blerja dhe marja-dhenia me qira e terreneve per ndertime civile e industriale.

Marja pjese dhe interesa ne ndermarrje e shoqeri shqiptare e te huaja qe kane objekte te njejta, te peraferta ose te lidhura me te.

Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pa caktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkakut .

Kapitali I Shoqeris

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise private “A&D SOLUTION ”sh.p.k do te jete 10.000 (dhjete mije leke). Kapitali eshte 100% nga kuotat e ortakut te vetem , e ndare ne 1 kuota .

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Drejtimi I Shoqerise


Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj Z.Ilirjan Agolli , ortakut i vetem dhe perfaqesuesi ligjor i saj prej dates se themelimit per nje periudhe 5 vjecare . Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem .



Neni 8

Ortaku i vetem themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale

Ka te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane .

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne 3 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise “A&D SOLUTION ”sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem .

Ortak i vetem themelues i

“A&D SOLUTION ”sh.p.k
Ilirjan Agolli

